

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro, gjyqtar referues e Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh.H., nga Gjilani, për shkak të veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, nga neni 339 par.3 lidhur me par.1, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.140/2014, të dt.15.01.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.15.10.2015, morri këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e PTH-DKR në Gjilan dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.140/2014, të dt.15.01.2015, vërtetohet.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.140/2014, të dt.15.01.2015 të akuzuarin Xh.H., e liron nga akuza për veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 për shkak se nuk është provuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë udhëzuar në kontest të rregullt civil ndërsa shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të shpenzimeve buxhetore të asaj gjykate.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ka ushtruar ankesë:

PTH-DKR në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ndaj ankesës së PTH-DKR në Gjilan, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit av. A.S., me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën e PTH-DKR në Gjilan, ta refuzoj si të pabazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPP, në këtë çështje penale nuk i ka ftuar palët për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme dhe se kemi të bëjmë me aktgjykim lirues.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.228/15, te dt. 14.05.2015, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore-DKR në Gjilan, ka propozuar që ankesa e PTH-DKR në Gjilan, të aprovohet si e bazuar dhe çështja penale të kthehet në rigjykim, ndërsa përgjigjja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 394 par.1 të KPP, shqyrtoi ankesën e PTH-DKR në Gjilan, të përgjegjës në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit, si dhe sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit, vlerësoi edhe shkresat tjera të lëndës dhe gjeti se:

Ankesat e PTH-DKR në Gjilan, është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës:

Ankesa e PTH-DKR në Gjilan pretendon, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP, për arsye se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i paqartë, i pa kuptueshëm dhe gjykata nuk jep arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, dhe nuk ka paraqitur vlerësimin e provave. Ankesa pretendon se gjykata vetëm i parafrazon fjalët e të akuzuarit Xh.H. duke i besuar deklaratës së tij, dhe gjen mbështetje në deklaratat e dëshmitarëve B.M., R.L. dhe L.M., duke bërë përshkrimin e deklaratave të tyre pa dhënë asnjë vlerësim, ndërsa në anën tjetër gjykata jep vlerësim jo objektiv të dëshmitarit L.B. edhe pse ai ka paguar 50Euro që të i nënshtrohet operacionit. Në raport me provat materiale në regjistrat nga repartet e ndryshme mbi inkasimin e mjeteve nga pacientët këto prova nuk i ka vlerësuar fare edhe për kundër asaj se regjistrat në fjalë dëshmojnë inkasimin në participim të pacientëve me emër dhe mbiemër e në shumë prej 11.450 Euro. Sipas ankesës edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe gjykata ka nxjerrë përfundim se i akuzuari në mungesë të provave lirohet nga akuza edhe për kundër vendimit numër 180 të datës 10.02.2010, të regjistrave nga repartet e ndryshme të spitalit mbi participimin e pacientëve si dhe dëshmisë së dëshmitarëve të cilëve i është shkaktuar dëm material në shumë prej 11.450 Euro.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të PTH-DKR në Gjilan, se aktgjykimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë dhe gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me aktgjykimin lirues me të cilin e ka liruar të akuzuarin Xh.H. dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë i kuptueshëm dhe gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare e kjo për arsye se në përshkrimin e dispozitivit të aktakuzës e cila ka qenë edhe objekt i shqyrtimit gjyqësor nuk ekziston asnjë palë e dëmtuar, përveç që përmendet shuma prej 11.450 Euro edhe nga ky përshkrim i dispozitivit të aktakuzës nuk mund të shihet qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm pasuror se i akuzuari këto mjete për këndë i përvetësoi, e si element qenësor për ekzistimin e veprës penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit, dhe gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota e në bazë të provave të nxjerra në shqyrtimin gjyqësor në dëgjimin e dëshmitarëve L.B., B.M., R.L. dhe L.M. si dhe nga raportet dhe regjistrat e reparteve të spitalit mbi inkasimin e mjeteve nga pacientët nga procesverbali i mbajtur i këshillit drejtues SRGJ i datës 10.02.2010, nga vendimi nr.724 të datës 20.05.2010, dhe me vendimin nr.885/2010 të datës 09.06.2010, janë lënë dy vendime të cekura më lartë e më qëllim të zbatimit të udhëzimit administrativ nr.04/2007, e në bazë të cilave i akuzuari është liruar nga akuza dhe lidhur me këto gjykata ka paraqitur arsye të qarta dhe të plota se cilave prova u ka besuar, e në të cilat prova është bazuar aktgjykimi lirues dhe aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet e pretenduara ankimore nga neni 384 par.1 nën par.1.12 e në lidhje me nenin 360 par. 7 të KPP.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas detyrës zyrtare në pajtim me nenin 394 par. 1 të KPP, edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, nga neni 385 par.1 të KPP, Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi nuk përmban asnjë shkelje rreth kësaj baze ankimore. Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar ligjin penal, në këtë çështje penale ku në veprimet e të akuzuarit nuk mund të shihet se i akuzuari e keqpërdori detyrën zyrtare me tejkalimin e kompetencave të tija, apo nuk i përmbushi detyrat e tija zyrtare, e

nga përshkrimi faktik i veprës penale rezulton se i akuzuari të ketë vepruar në mënyrë të ligjshme për arsye se në përshkrimin faktik nuk ekzistojnë persona të dëmtuar, nuk ekziston qëllimi i kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit, e cila vërtetohet nga ajo se vendimi është marrë nga këshilli drejtues e me qëllim të përmisimit të mjeteve financiare që pacientëve të ju ofrohen shërbime më cilësore, dhe nga kjo mund të përfundohet se i akuzuari veproi në kuadër të kompetencave të tija si drejtor ekzekutiv, dhe në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar ligjin penal i cili është i pranueshëm edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejt ka aplikuar dispozitat e procedurës penale, me vlerësimin e secilës provë veç e veç, e me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike. Pretendimi ankimor i PTH-DKR në Gjilan, se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është liruar nga akuza nuk qëndron kjo për arsye se dëshmitarët B.M. shef i financave, Rexhep Limoni i cili ka bërë grumbullimin e mjeteve nga participimi i 28 njësisive të spitalit dhe L.M. shefe e kontabilitetit të gjithë nuk e kontestojnë vendimin nr.180 të dt.10.02.2010 i cili është marrë nga këshilli drejtues, e drejtor ekzekutiv i të cilit ka qenë i akuzuari Xh.H., dhe mjetet e inkuasura nga pacientët janë dërguar në llogari të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilën gjë e ka konstatuar edhe njësitit i auditimit, dhe se pastaj nga këto mjete të cilat janë dorëzuar në Ministrinë e Shëndetësisë një pjesë e këtyre iu është kthyer SRGJ, e nga kjo konkludohet se edhe Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndërmarr asnjë masë, e kjo për arsye se sipas marrëveshjes së Ministrisë së Shëndetësisë është dashur të mbledhen më tepër mjete vetanake nga spitalet e me qëllim të përmisimit të pozitës materiale të SRGJ e me qëllim të afarizmit më të mirë dhe shërbimet shëndetësore të jenë sa më cilësore për pacientët, e nga kjo mund të konkludohet se i akuzuari nuk ka pasur për qëllim përvetësimin e dobisë pasurore për vete, e përveç kësaj vendimi i cekur më lartë e për të cilin akuzohet i akuzuari është marrë nga këshilli drejtues e në pajtim me Ministrinë e Shëndetësisë e në favor të përfundimit të këtillë është edhe vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë nr.34-5/2011 të dt.27.04.2011, me të cilin është formuar grupi punues e me qëllim të mbledhjes më shumë të mjeteve vetanake për spitalet, e në të cilin grup ka qenë i emëruar edhe vetë i akuzuari Xh.H..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe arsyet e paraqitura mbi faktet vendimtare nga ana e gjykatës së shkallës së parë, shihet qartë se te i akuzuari nuk ka ekzistuar qëllimi i përvetësimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme si element qenësor për ekzistimin e veprës penale, e në mungesë edhe të personave të dëmtuar të cilët fare nuk ekzistojnë në përshkrimin faktik të aktakuzës gjykata e shkallës së parë me paraqitjen e provave në aktgjykim në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Siç u cek edhe më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me refuzimin e ankesës të PTH-DKR në Gjilan e sipas dispozitës së nenit 401 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.233/2015, të dt.15.10.2015

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi

Kryetari i Kolegjit,

Vahid Halili